



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 321

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT, TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. BEQIR ZEK MULAJ, KANDIDAT PËR KRYETAR BASHKIE, I PROPOZUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR BASHKINË HAS**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Beqir Zek Mulaj, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për Bashkinë Has.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Nenet 5 dhe 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi

Data 12.4.2023 Nr: 321
Ora:12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Beqir Zek Mulaj, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për Bashkinë Has".

kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte, ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtar në këshillin bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Beqir Zek Mulaj, është regjistruar si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga "Partia Socialiste e Shqipërisë", për Bashkinë Has.

Për këtë kandidat, në datën 1.4.2023, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili, është regjistruar me nr. unik KU-PS-14367. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë, nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Beqir Zek Mulaj, rezulton:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij, emri i mëparshëm: Halit
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", nga Gjykata Durrës, dënuar me 50 ditë punë publike, sipas nenit 63, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë
- Pyetjes 2 "A jeni dënuar me burgim, me vendim gjyqësor jopërfundimtar, nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale, të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?", subjekti i vetëdeklarues është përgjigjur "PO", nga Gjykata Krujë, dënuar me kusht, sipas nenit 59 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, jo të formës së prerë, pasi është ankimuar në Gjykatën e Apelit
- Pyetjes 3 "A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO". Nga Gjykata e Lubjanës, Slloveni, dënuar me gjobë, për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Në vitin 2003, është ndaluar në Doganën e Vernicës, për verifikim dokumentash. Në vitin 2009, është ndaluar në Gjakovë, Kosovë, për verifikim dokumentash.
- Pyetjes 4 "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", në vitin 2021 është proçeduar nga Prokuroria e Krujës, për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.
- Pyetjes 8 "A keni jetuar ndonjëherë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", nga viti 1996 deri në vitin 2000, ka jetuar në Greqi, për arsye emigrimi, dhe ka qënë vizitor ne Angli, por pa përcaktuar muajin

ose vitin e qëndrimit.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve, si më sipër, në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë, në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja.

Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime. Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Beqir Zek Mulaj, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për Bashkinë Has, dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI